

kontratën kolektive të mësimdhënësve. Disa projekte të investimeve kapitale janë realizuar plotësisht, disa janë në vazhdimësi, dhe me gjithë këto vështirësi, Komuna dhe ne si Ezzekutiv, do të bëjmë përpjekje maksimale t'i realizojmë premtimet dhe programin tonë qeverisës. Sa u përket projekteve, fjalën ia kaloj drejtori të Urbanizimit, Driton Mulaj.

Drejtori i Urbanizimit, Driton Mulaj: Përshëndetje të gjithëve. Gjatë këtij viti janë realizuar projektet sipas planit të punës që është miratuar në Kuvendin Komunal. Projektet kapitale: punime në rrjetin e ujësjellësit në Burojë, kanalizimi në bashkësitë lokale, projektet e ndërtimit të trotuarve në fshatra, aktualisht jemi në Prekaz dhe Polac, po punohet sipas planit. Unaza e jashtme e qytetit, projekti i kanalizimit fekale në fshatrat Acarevë, Kopiliq të Poshtëm, Prekaz, Pemishtë, etj. Projekti i ujësjellësit në fshatrat e Bashkësisë Lokale në Qirez, shtrirja e gypit kryesor. Janë duke u realizuar projektet e subqendrave në Likoc, Runik dhe Qirez. Drejt përfundimit është edhe projekti i objektit banesor për kategoritë e luftës (U). Vitin e ardhshëm do të nis subqendra tjetër, ajo në KLinë të Epërme. Projekte rrugore në fshatrat e komunës, projekti infrastrukturor në Qyqavicë, projekti Syriganë – Bjeshkët e Syriganës.

Kryetari Nura: Kemi përfituar grantin e përformancës në vlerë prej 1 milionë euro. Kemi nisur realizimin e projektit të ndriçimit publik në të gjitha fshatrat, projekt që vazhdon në vitet në vazhdim. Sa i përket mirëmbajtjes së hapësirave publike dhe ambientit, e kemi fuqizuar ndërmarrjen Eko Natyra me pajisje të reja për punë, makineri e nevojshme për pastrim dhe mirëmbajtje. Në fushën e arsimit, kemi realizuar projekte për rinovim të objekteve shkollore, kemi intervenuar në catinë e objektit të shkollës Anton Cetta dhe në objektin e shkollës në Qirez.

Kadri Zeka: Një pyetje për ujësjellës dhe kanalizim. Kur pritet të përfundojnë këto në fshatin Abri. Si dhe ndriçimi publik a pritet sivjet a vitin e ardhshëm.

Sadri Gaxhiqi: Kam një kërkesë sa i përket ujësjellësit në Abri. Ujë nuk ka. Kanalizimi nuk ka përfunduar. Ka rrugë që janë dëmtuar nga kanalizimi dhe kompanitë që kanë punu, nuk e kanë kthyer në gjendje të mëpërmshme.

Dardan Thaci: Në Burojë kur realizohet projekti i ujësjellësit